



VËREJTJE: Të gjitha marrëveshjet dhe formularët janë standarde dhe në pajtim me rregullat ligjore të zbatueshme, politikat e brendshme dhe procedurat e Bankës. Përkthimi i autorizuar në gjuhën shqipe shërben vetëm për t'i kuptuar më mirë ato. Ky dokument është valid vetëm nëse është i plotësuar, nënshkruar dhe i dorëzuar në gjuhën maqedonase.

Nr. _____

Shkup, _____

MARRËVESHJE

Për hapjen dhe udhëheqjen e llogarisë së transaksionit për kryerjen e qarkullimit pagesor në vend

E lidhur në Shkup më datë _____, midis:

1. Bankës Komerciale SHA Shkup (në tekstin e mëposhtëm: Banka), e përfaqësuar nga _____

2. _____, (në tekstin e mëposhtëm: Posedues i llogarisë së transaksionit), e përfaqësuar nga _____.

Llogaria _____

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Marrëveshje rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella midis Bankës dhe Poseduesit të llogarisë së transaksionit në lidhje me hapjen, udhëheqjen dhe punën me llogarinë e transaksionit për kryerjen e qarkullimit pagesor në vend në pajtim me rregullat ligjore në fuqi dhe kushtet e përgjithshme për hapjen, udhëheqjen dhe punën me llogaritë e transaksionit në vend të përshkruara nga Banka.

Hapja dhe udhëheqja e llogarisë së transaksionit

Neni 2

Banka në bazë dhe nën kushtet e kësaj Marrëveshjeje, hapë llogari transaksioni, nëpërmjet të cilës Poseduesi i llogarisë së transaksionit kryen pagesa, edhe atë: pagesë të parave të gatshme në llogari, transfere të mjeteve nga njëra në tjetrën llogari të transaksionit dhe pagesë me para të gatshme nga llogaria.

Neni 3

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, Poseduesi i llogarisë së transaksionit i pranon Kushtet e përgjithshme të përshkruara nga ana e Bankës, edhe atë:

- Kushtet e përgjithshme për hapjen dhe udhëheqjen e llogarisë së transaksionit për kryerjen e qarkullimit pagesor në vend,
- Kushtet e përgjithshme për përdorimin e shërbimeve elektronike bankare.

Nëpërmjet këtyre kushteve, Banka në pajtim me politikën e saj afariste i përcakton kushtet e përgjithshme për kryerjen e qarkullimit pagesor në vend dhe për realizimin e kësaj Marrëveshjeje.

Banka e mban të drejtën t'i ndryshojë kushtet e përgjithshme, për ç'gjë paraprakisht e njofton Poseduesin e llogarisë së transaksionit. Konsiderohet se Poseduesi i llogarisë së transaksionit i pranon kushtet e ndryshuara, nëse në afat prej 15 ditëve nga pranimi i tyre, nuk dorëzon kërkesë për prishjen e Marrëveshjes dhe mbylljen e llogarisë së transaksionit.

Poseduesi i llogarisë së transaksionit obligohet se gjatë realizimit të qarkullimit pagesor do të respektojë orarin e punës në fuqi të Bankës, të publikuar në Bankë.

Neni 4

Poseduesit të llogarisë së transaksionit, Banka i jep kartë për llogarinë e transaksionit të personit juridik.

Personave të autorizuar për tërheqjen e raporteve, dorëzimin e urdhëresave dhe/ose të autorizuar për tërheqjen e parave të gatshme nga llogaria e transaksionit të hapur me Marrëveshje të posaçme, Banka u jep karta identifikimi për secilin person në veçanti, duke dhënë numra të posaçëm të ID-së.

Gjatë marrjes së kartës së identifikimit, secili person, që nga Poseduesi i llogarisë do të fitojë privilegje adekuate, nënshkruan Deklaratë për pranimin e kartës së identifikimit.

Me qëllim të mbrojtjes së interesave të tyre, personat të cilët posedojnë kartë për identifikim janë të detyruar të mbajnë llogari për mënyrën e përdorimit, ruajtjes së ndërgjegjshme të kartës dhe në këtë mënyrë numri ID nuk do të jetë pa nevojë i dukshëm dhe i kapshëm për personat e paautorizuar.

Banka nuk mban përgjegjësi nëse vjen deri tek keqpërdorimi i kartës ose numri ID.

Neni 5

Poseduesi i llogarisë së transaksionit, në pajtim me rregullat ligjore, obligohet që për çfarëdo lloj ndryshimi të personave juridikë për tërheqjen e raporteve, dorëzimin e urdhërpagesave dhe/ose personi i autorizuar për tërheqjen e llogarisë së transaksionit ta njoftojë Bankën dhe të dorëzojë dokumente adekuate për ndryshimin e kryer.

Për dëmin eventual të ndodhur që, Poseduesi i llogarisë, si rezultat i njoftimit të vonshëm nga ana e poseduesit të llogarisë së transaksionit, nga mosnjoftimi në kohë nga ana e poseduesit të llogarisë së transaksionit, Banka nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi.

Mënyra e realizimit të qarkullimit pagesor

Neni 6

Poseduesi i transaksionit është i detyruar të dorëzojë instrumente pagesore të plotësuar në mënyrë të rregullt dhe të saktë.

Banka nuk mban asnjë përgjegjësi për realizimin e urdhëresave të plotësuara gabimisht nga ana e Përdoruesit. Për instrumentet pagesore të plotësuara gabimisht dhe që nuk do të realizohen, Banka do ta njoftojë Poseduesin e llogarisë. Poseduesi i llogarisë obligohet që instrumentet pagesore në bankë t'i dorëzojë personi i autorizuar, duke dëshmuar identitetin nëpërmjet kartës së identifikimit.

Neni 7

Banka realizon pagesa nga llogaria e transaksionit të Poseduesit të llogarisë në lartësinë e mbulesës së llogarisë së transaksionit. Me mbulesë nënkuptohet gjendja e llogarisë së transaksionit nga dita paraprake e punës, e zvogëluar për të gjitha pagesat e realizuara nga llogaria e transaksionit së bashku me provizionin bankar deri në momentin e vërtetimit të saldos, por të zmadhuar për pagesat e evidentuara në llogarinë e transaksionit në ditën rrjedhëse dhe shtuar për interesin maturuar, por të pashfrytëzuar të bazë të kredisë kornizë revolving.

Banka mund të miratojë revolving kredi në denarë për tejkalimin e gjendjes së mjeteve në llogarinë e transaksionit të lidhur me marrëveshjet e veçantë me Poseduesin e llogarisë.

Neni 8

Poseduesi i llogarisë së transaksionit mund ta autorizojë Bankën të kryejë pagesa në emër dhe për llogaritë të tij drejt personave të tretë. Autorizimi jepet në formë të shkruar, me emërtimin e të gjitha elementeve të nevojshme për kryerjen e pagesës:

- Llogaria e transaksionit me ngarkesë të së cilës kryhet pagesa
- Shuma
- Llogaria e urdhërpranuesit
- Data e realizimit të pagesës

Nëse Poseduesi i llogarisë së transaksionit anulon autorizimin e dhënë paraprakisht, ose i ndryshon instruksionet e dhëna paraprakisht është i detyruar ta njoftojë Bankën në afat prej 5 ditëve para ditës së realizimit të pagesës.

Neni 9

Poseduesi i llogarisë së transaksionit e autorizon Bankën ta ngarkojë llogarinë e tij të transaksionit sipas reklamacioneve të qarkullimit ditor të pranuar të çeqeve pa garanci të llogarive rrjedhëse të qytetarëve.

Përlllogaritja e normës së interesit

Neni 10

Mjetet e llogarisë së transaksionit të Poseduesit të llogarisë së transaksionit janë mjete në të parë, me të cilat Poseduesi i llogarisë së transaksionit mund të disponojë në çdo kohë. Banka bën llogaritjen e normës pasive të interesit të llogarisë së transaksionit në fund të çdo muaji, në pajtim me Vendimin e normës së interesit të Bankës. Normën pasive të interesit banka do ta paguajë çdo muaj.

Norma e interesit për mjetet në të parë, në ditën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, llogaritet në nivel vjetor.

Kompensim për realizimin e shërbimeve

Neni 11

Poseduesi i llogarisë së transaksionit obligohet që t'i realizojë shërbimet nga kjo Marrëveshje dhe në bazë të saj t'i paguajë Bankës kompensim në lartësinë, afatet dhe mënyrën në pajtim me Tarifën për kompensim të shërbimeve që i realizon Banka.

Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, Poseduesi i llogarisë së transaksionit e autorizon Bankën dhe i jep urdhëresë të pakthyeshme që t'i paguajë kompensimet dhe shpenzimet nga qëndrimi paraprak në ngarkesë të mjeteve të llogarisë së transaksionit.

Njoftime

Neni 12

Për gjendjen dhe ndryshimet e ndodhura në llogarinë e transaksionit, Banka obligohet ta njoftojë Poseduesin e llogarisë së transaksionit me dorëzimin e Raportit të ndryshimeve dhe gjendjen e llogarisë së transaksionit, në mënyrën e përcaktuar nga Poseduesi i llogarisë së transaksionit.

Konsiderohet se Poseduesi i llogarisë së transaksionit e pranon raportin nëse të njëjtin nuk e konteston në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit.

Bartësi i llogarisë së transaksionit obligohet që në mënyrë adekuate ta njoftojë Bankën për pritjet e mjeteve të hyra dhe mjeteve të dalura në shumat të mëdha në llogarinë e transaksionit.

Të gjitha njoftimet në lidhje me këtë Marrëveshje, Banka ia dorëzon Poseduesit të llogarisë së transaksionit në adresën e selisë së regjistruar me dërgesë rekomanduese.

Lidhur me këtë, Poseduesi i llogarisë obligohet ta informojë rregullisht Bankën edhe për ndryshimin e të gjitha të dhënave që i ka dorëzuar gjatë lidhjes së kësaj Marrëveshjeje, më së voni në afat prej tri ditëve nga dita e ndryshimit të ndodhur, në të kundërtën banka nuk mban përgjegjësi për pasojat e ndodhura për shkak të mosnjoftimit të ndryshimit.

Poseduesi i llogarisë së transaksionit është i detyruar që ta kontrollojë saktësinë e raporteve dhe nëse vëren padrejtësi është i obliguar të dërgojë parashtresë në afat prej 2 (dy) ditëve nga dita e marrjes së raportit. Banka obligohet se do ta shqyrtojë dhe do të përgjigjet lidhur me parashtresën në afat prej 8 (tetë) ditëve.

Mbrojtja e të dhënave

Neni 13

Banka në pajtim me rregullat ligjore në fuqi, të dhënat e llogarisë së transaksionit i transferon në Regjistrin unik të llogarive të transaksionit, i cili udhëhiqet nga Shtëpitë e Kliringut dhe është bazë e vetme e të dhënave dhe evidencës së poseduesve të llogarive në qarkullimin pagesor vendor, i dedikuar për realizimin e qarkullimit pagesor, kontrollin e llogarive të transaksionit dhe sigurimin e informacioneve.

Palët obligohen se si të besueshme do t'i ruajnë të gjitha të dhënat, veprimet dhe rrethanat për të cilat kanë marrë njohuri lidhur me realizimin e kësaj Marrëveshjeje, përveç asaj që është e përshkruar me rregullat në fuqi, ose nëse nuk merren vesh ndryshe.

Afati i vlefshmërisë dhe ndërprerja e Marrëveshjes

Neni 14

Kjo Marrëveshje lidhet për periudhë të pacaktuar kohore. Secila nga palët mund ta prishë marrëveshjen nëpërmjet njoftimit me shkrim dërguar deri te pala tjetër me afat anulimi prej një muaji. Poseduesi i llogarisë së transaksionit mund ta prishë këtë marrëveshje vetëm nëse me këtë nuk i shkel dispozitat nga kjo Marrëveshje, Kushtet për hapjen dhe udhëheqjen e llogarive të transaksionit për realizimin e qarkullimit pagesor në vend dhe marrëveshjeve të tjera të lidhura në

Bankë dhe nëse para mbylljes së llogarisë së transaksionit i kryen të gjitha detyrimet që dalin nga kjo Marrëveshje.

Banka ka të drejtë në mënyrë të njëanshme ta prishë Marrëveshjen edhe pa afat anulimi, nëse vëren se Poseduesi i llogarisë së transaksionit sillet në kundërshtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, kushteve të punës dhe rregullave në fuqi ose në bazë të vendimit/urdhëresës së organit përgjegjës dhe për të njëjtën do ta njoftojë Poseduesin e llogarisë së transaksionit.

Banka ka të drejtë në mënyrë të njëanshme ta prishë Marrëveshjen nëse në 2 (dy) vitet e fundit në llogarinë e transaksionit nuk ka patur mjete dhe qarkullim dhe nuk ka qenë e bllokuar.

Në rast të prishjes së Marrëveshjes, Banka do t'i transferojë mjetet nga llogaria e transaksionit të Poseduesit të llogarisë së transaksionit në llogari tjetër të transaksionit, në përputhje me instruksionet e dhëna nga Poseduesi i llogarisë së transaksionit dhe nëse në afat prej 8 (tetë) ditëve, Poseduesi i llogarisë së transaksionit nuk dorëzon instruksione, Banka do t'i transferojë mjetet në llogari tjetër sipas zgjedhjes së saj.

Në rastet kur Banka e mbyll llogarinë e transaksionit në bazë të vendimit/urdhëresës së organit të autorizuar, transferimin e mjeteve nga llogaria e transaksionit e realizon në pajtim me instruksionet e organit të autorizuar.

Dispozitat përfundimtare

Neni 15

Për gjithçka që nuk është paraparë në këtë Marrëveshje vlejné dispozitat ligjore dhe aktet e politikës afariste të Bankës.

Neni 16

Në rast të kontestit, kompetent është Gjykata e Shkupit.

Neni 17

Marrëveshja është përpiluar në dy kopje identike, nga një për secilën palë.

Neni 18

Marrëveshja është lidhur dhe hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët.

**POSEDUESI I LLOGARISË SË
TRANSAKSIONIT**

**BANKA KOMERCIALE
SHA SHKUP**

(nënshkrimi dhe vula e personit të autorizuar për përfaqësim)